

## “Perëndia” dhe “Zoti” në gjuhën shqipe

### Ngjyrimet kulturore në terminologjinë spirituale

#### At Foti Cici

Në dëgjim të parë fjala *Perëndi*<sup>1</sup> duket më rituale, më pak e përditshme, jo e standardit, ndërsa fjala *Zot* si më e përdorshme nga shqiptarët, më e thjeshtë, e drejtpërdrejtë, jo liturgjike. Ku është ndryshimi midis dy fjalëve? A mund të alternohen këto përdorime në shqipen e sotme? Cili term ka përparësi në përdorim? Ndërsa fillojmë të mendojmë e të pyesim, na del një pyetje tjetër: Çfarë gjinie ka *Perëndia* në gjuhën tonë? A mund të jetë *Perëndia* e gjinisë mashkullore?

Shumë prej nesh nuk i kanë menduar pyetje të tilla, sepse çdo gjë e natyrshme në gjuhë nuk ngre pyetje. Të huajt, veçse, janë të parët që e shquajnë dukurinë në fjalë, e madje si “çrregullsi”, të paktën, në përpjestimet e gjinisë, por dhe të synimeve kuptimore. Një çast i tillë, si dhe habitorja e vendorëve për t’u përgjigjur, u jep nxënësve të shqipes njëfarë ngushëllimi në ndërlikimet e sigurta të gramatikës sonë. Edhe përkthyesit, sidomos rishtarët e misionëve, befasohen kur për herë të parë iu kërkohet të përkthejnë tjetër për tjetër emra e përemra kaq “absolutë” në gjuhë të tjera.

Në këtë shkrim nuk kam për qëllim arsyetimin e ngurtë të pyetjes mbi gjininë e “Perëndisë”, a të Perëndisë, as thellimin kuptimor tek nocioni “Zot”. Ndalesa ime është vëzhgimi i fjalëve në përzgjedhjet e përdoruesve të shqipes, por sidomos duke lexuar disa nga klasikët e letërsisë shqipe, për të regjistruar shpengimin a qëllimshmërinë si ngjyrimet etnokulturore. E duke bërë këtë, nuk bëjmë gjë tjetër veçse pohojmë një pikë sfiduese në ideologjinë e lëmit përkthimor të letrave tona.

#### “Perëndia” dhe “Zoti”

Institucionet e sotme spirituale këmbëngulin se *Perëndia* është ajo fjalë që shpreh atë që thotë greqishtja *Theós* dhe anglishtja *God*, ndërsa fjala *Zot* është ajo që thuhet *Kyrios* dhe *Lord*, përkatësisht të këto dy gjuhë. Por ja që shqipja

---

<sup>1</sup> Për të lehtësuar leximin përdoren italikë tek termat *Perëndi* e *Zot*, si dhe tek mbiemrat dhe përemrat e tyre.

nuk është kaq e thjeshtë sa ç' duket me të parën. Jemi të detyruar të pranojmë, për të ruajtur përpjestimet historike të shqipes spirituale, se një përdorim i tillë mund të sugjerohet vetëm në gjuhën adhurimore, në terminologjinë liturgjike të ortodoksëve (Flas për zonën ortodokse sepse atje kam liri të plotë përshkrimi e sugjerimi). Përndryshe fjala *Zot* në shqipe ka të njëjtin përkthim me atë *Perëndi*, gjë që fjala *Kyrios* nuk e ka me atë *Theós*, dhe as fjala *Lord* me atë *God*.

Kur shqiptarët shprehen për t'iu referuar realitetit hyjnor, ata thonë, “a beson në *Zot*”, “a ka *Zot*”, “ta bëftë *Zoti* mirë”, “dhëntë *Zoti*”, e shumë të tjera, duke e lënë të shprehurit me “*Perëndi*” për trajtat dialektore, a diçka shumë të veçantë, poetike a rituale. Kjo nuk ndodh në gjuhë të tjera. Në greqishte dhe në anglishte, për shembull, *Zoti* është biri i *Perëndisë*, por jo vetë *Perëndia*.

Bashkëkohës që flasin e lërojnë shqipen standarde, përdorin *Zot* si përzgjedhje të drejtpërdrejtë, të sigurt në formulim. Për shembull: “...Shqipërinë e ruan *Zoti* dhe jo qeveria” (Besnik Mustafaj).<sup>2</sup> Ndërsa fjala *Perëndi* ka më tepër përdorim nuancor, poetik, paksa rrëshqitës nga kompaktësia e standardit: “Fuqi të tilla duken si një *perëndi* e rrezikshme” (Mimoza Ahmeti).<sup>3</sup> Përveç përzgjedhjes së *perëndisë*, si përkije tej përditshmërisë në shprehje, duket qartë dhe gjinia e *Perëndisë*, e cila e ka natyrshmërinë në femërore: “perëndi e rrezikshme”, në një kohë që në terminologjinë kishtarë kjo është “mashkullorizuar”: “Perëndi i madh”, për shembull.

Ndryshimi i gjinisë së *Perëndisë* nga femërore në mashkullore, është aq i vjetër sa ç'është dhe kuptimi i sotëm i kësaj fjale, siç do të shohim më poshtë. Shndërrimi i gjinisë u ndërfut si pasojë e ideologjisë së krishterë në përkthim, ku *Zoti* është i simbolizuar mashkull dhe duhet që me domosdo të jetë i gjinisë mashkullore, siç është në gjuhët e teksteve origjinale. Shumë pararendës, sidomos Kristoforidhi, iu dorëzuan kësaj bindjeje, duke e gjuhëzuar *Perëndinë* në gjininë mashkullore. Asnjë botim i traditës, veçse, nuk është qind për qind i njëtrajtshëm në këtë pikë. Kristoforidhi, si dhe të tjerë mbas tij, ka lënë të dokumentuar shembuj natyrorë të shqipes, ku *Perëndia* është e gjinisë femërore, dhe jo ashtu siç planifikonte përkthyesi.<sup>4</sup>

---

<sup>2</sup> *Koha Jonë*, 21 mars 2004.

<sup>3</sup> *Shekulli*, 20 maj 2004.

<sup>4</sup> “... që të ngrerë krye kundër Perëndisë’ së gjallë” (*Dhiata e Re*, “Mbë Ebrenjtë”, 3:12, Korçë 1930). Në këtë rast Kristoforidhi e lakon *Perëndinë* në femërore, së gjallë, ndërsa në versionin gegërisht (1872), i njëjti varg nuk ka nyja: “qi të ngrerë krye kundër *Perëndisë* gjallë” ([www.ShqiptarOrtodoks.com/Tekste biblike](http://www.ShqiptarOrtodoks.com/Tekste_biblike)).

Duke folur për gjininë e *Perëndisë*, vlen të lexohet shkrimi i Valery M. Sardushkin, filologe e Universitetit të Shën Petersburgut në Rusi, në punimin e saj “Is ‘God’ in Albanian feminine or masculine?” (*The Bible Translator*, 53/1, 2002, f. 137-143), e cila ka gjetur pothuaj në të gjitha përkthimet biblike në shqipe, përdorime të *Perëndisë* në femërore, edhe pse synimi i përkthyesve ishte për ta paraqitur gjithmonë në mashkullore.

Ata që imitojnë sot tekstet e traditës spirituale në drejtshkrim, janë vetë ata me përvojë spirituale. Përndryshe përdoruesit e sotëm përdorin fjalën *Zot*, ndërsa kur nevojitet *Perëndi*, kjo shtrihet sipas përmasës së saj kulturore; në gjininë femërore. Një përdorim të kujdesshëm hasa në shtyp, tek po lexoja një shkrim nga një filolog i mirënjohur: "Po sikur një nxënës [...] të thoshte: 'Perëndia *jonë* është i vetmi Zot që bëri botën'..." (Edmond Tupja).<sup>5</sup> Këtu vihet re përkujdesja e shkruarit, sepse gjinia e *Perëndisë* është femërore, *jonë*, por më tutje, nga dilema për të shkruar "E Vetmja që bëri botën", autori negociohet me alternimin "i vetmi Zot". Por jo të gjithë janë kaq ndijimorë në nuancat e shqipes.

Sidoqoftë, ky përshkrim përmbledhës tregon se, pavarësisht nga ngulmi i institucioneve fetare për disa breza, shqiptarët e sotëm vazhdojnë të ruajnë përdorimin kulturor të fjalës *Perëndi*, duke e lakuar atë në gjininë femërore, por duke u distancuar nga përdorimi i plotë brenda saj, e sidomos duke u siguruar tek fjala *Zot*, si më përcaktuese në shqipen e sotme.

Në fakt, i Epërmi që na është simbolizuar si i gjinisë mashkullore, teologjikisht është tej gjinive, pra është i pagjinishëm, që për ne njerëzit do të thotë se është i dygjyishëm. Në qoftë se kjo nuk ekziston në gjuhë të tjera bashkëkohore, kush e ka fajin që rasti shqiptar po përdhuhet? Sado absurde që të jetë kjo për ata që nuk e flasin shqipen që për së vogli, rrugëtimi i kësaj trajte të rrallë përmes shqipes së shekujve të fundit shpreh një nga pikat për përjasje ndërghjuhësore. Sikleti për të pranuar një Perëndi të gjinisë femërore, është më i vogël sesa pranimit dhe dhunimit të intuitës gjuhësore, të paktën në tekstet jashtë adhurimit.

Para se të lexojmë disa nga klasikët tanë, vlen të shënojmë se fjala *Perëndi* në shqipe fillimisht do të thoshte *mbretëri* dhe jo *Zot*. Tek Matrënga, për shembull, *Perëndi* përdoret në vend të fjalës *mbretëri*, siç duket dhe nga teksti italisht përbri: *Perëndia e qiellvet – il regno di cieli*.<sup>6</sup> Ndërsa fjala *Perëndeshë* përdoret atje për Marinë, në vend të fjalës *mbretëreshë*: "Falemi, *Perëndeshë*, ëma e elejmosinit" (dio ti salvi *regina madre* di misericordia).<sup>7</sup> Kështu është e regjistruar kjo tek autorët e vjetër shqiptarë deri tek *Anonimi i Elbasanit*, ku *Perëndi* përdoret me kuptimin *Zot*, por *Perëndesha* ende quhet *Mbretëresha*, për *Hyjlindësen*, Marinë. Kjo dukuri ka ngjyruar dhe përkthimin e Anonimit në anglishte, nga vetë Dr. Robert Elsie, i cili e përktheu këtë në "Hyjneshë": "*PRDsha* denj më gjunjë e ra.../ *The Goddess* [?!] fell to her kness...".<sup>8</sup> Pra, midis viteve 1592-1761, mbas

---

<sup>5</sup> *Panorama*, 16 janar 2005.

<sup>6</sup> "Lumtë ata që janë vabëk shpirti/ pse e tireja ishtë *perëndia e qiellvet*" (Beati sono li poveri di spirito/ perciocché di loro é *il regno di cieli*), Matteo Sciambra, *La "Dottrina Cristiana" Albanese* di Luca Matranga, Citta del Vaticano, 1964, f. 81.

<sup>7</sup> Po aty, f. 47.

<sup>8</sup> Robert Elsie, *The Elbasan Gospel Manuscript (Anonimi i Elbasanit), 1761, and the struggle for an original Albanian alphabet*, 1995, vargjet 8/05, cituar nga [www.elsie.de](http://www.elsie.de). Këtu përkthyesi fjalën "Perëndesha" e ka përkthyer *Gooddessa* (Hyjneshë), dhe jo *Queen* (Mbretëreshë), siç konceptohej kjo nga autori i *Anonimit*.

Matrëngës e para Anonimit, duket se ka ndodhur ndryshimi i kuptimit të *Perëndisë* në shqipë; nga *Mbretëreshë* në *Zot*.

## Naim Frashëri: Në zëmrët tënë e gjejmë Zonë

Naim Frashëri përdor me të njëjtën lehtësi *Perëndi* dhe *Zot*, përveçse kur kërkon të përftojë rimën, nën shtrëngesën e rrymave poetike të modeleve të tij: “Po të nderojë njeriu njerinë/ e ka nderuar dhe *Perëndinë/ Në zëmrët tënë e gjejmë Zonë/ shtëpi*’ e ti ‘shtë zëmëra jonë’”.<sup>9</sup> Në vitet e tij kuptimi i emrave *Perëndi* e *Zot* ishte njësoj si sot, por ama i njëjtë duket dhe përdorimi, gjë që sot është shpërpjestuar.

*Perëndia* për Naimin ishte ashtu siç e ka shqipja, në gjininë femërore. “Fuqit’ e *Perëndisë/ duket tekdo/ se shpirt’i gjithësisë/ po është ajo*”.<sup>10</sup> Përderisa Naim Frashëri nuk ishte i krishterë, e kishte më të lehtë të shkruante shqip siç ndjente, ndërsa intelektualët e krishterë ato vite, si Kristoforidhi për shembull, krijonin nën një trysni gjuhësore, përderisa ata që investonin për të shtypur librat e tij shqip nuk kishin synime kombëtariste në gjuhë, por vetëm spirituale. Nëpërmjet përkthimeve ne trashëguam shumë, por midis tyre ndjemë dhe tëhuajtje të shqipes.



<sup>9</sup> *Besojmë, Lulet e Verësë*, cituar nga Naim Frashëri, *Vepra letrare 1*, 1995, f. 48.

<sup>10</sup> *Zëmëra*, po aty, f. 45.

## Faik Konica: Perënditë janë të kënaqura nga patriotizma juaj

Faik Konica përdor më shumë *Perëndia* sesa *Zoti*, edhe pse nuk mohon asnjë trajtë. Edhe ky ruan gjininë femërore, por jo gjithmonë: “Të lëvdohet *Perëndinë* që krijoi bukuri/... S’është *i ashpër*, pa mëshirë/ është *i fortë* dhe *i mirë*.”<sup>11</sup> Pak më poshtë Konica flet për *Zotin* dhe nuk dihet se në ç’varg e ka ndarë nga mendja e tij aq detajuese *Perëndinë* nga *Zoti*: “Lëvdim *Zotit* plot me shie/q’i dha botës këtë hie”. Në prozën shqipe, ku Konica është i përhershëm, ai e ka përdorur gjerë fjalën *Perëndi*, dhe madje shumë të lakuar në femërore: “*Perënditë*, thanë pleqtë, janë të kënaqura nga patriotizma juaj...”.<sup>12</sup> Sidoqoftë, ky rast nuk është kaq i vështirë sa ç’është ky që vijon, ku autori ka bërë mbitheksime, gjë që tregon se e ka peshuar mirë përdorimin: “S’ka forcë as fuqi veç se te *Perëndia*, e Larta, e Madhia!”<sup>13</sup>

Në gjuhën e Konicës nuk fshihet përkujdesja e intelektualit në përzgjedhjet e terminologjisë spirituale, e cila ende sot nuk është e shpenguar. Ka disa pika ku Konica jep opinione të vlefshme. Në qëmtimin që vijon, për shembull, bëhet dallim mbi përdorimin *shpirtëror* dhe *spiritual* në shqipe, një nuancë që vështirë të përftohet dhe në shkrimet e mendimtarisë së pasdiktaturës: “... muzika, përveç pëlqimit estetik që na jep si art, ka edhe një fuqi *spirituale* që shvillon hollësin’ e *shpirtit*”.<sup>14</sup> Dhembshuria për shqipen sot, na çon ndonjëherë dhe në purizëm, si në rastin *shpirtëror*, me të cilin mjaft bashkëkohës mbulojnë edhe atë *spiritual*.

Kur Konica fjalëson brenda religjioneve, ai jo vetëm vëzhgon e respekton shqipen e tyre, por përdor e ndihmon, qoftë dhe kur rrëmbehet: “... e, me ato duar qi në mëgjes zunë *Eukaristin* të peshosh copët e turpëshme të botës”.<sup>15</sup> Tek e njëjta polemikë me atin katolik, ai e nuancon debatin duke ruajtur termat gjuhësorë të kundërshtarit: “T’isha *ipeshkëv* unë, një zet-e-katër orë nuk u a kisha për të lënë më *meshën* priftërve si ty”.<sup>16</sup> Ndërsa kur i referohet Nolit, ai e përmend atë si *Peshkop* dhe jo *Ipeshkëv*, sepse dëgjon e sugjeron edhe për fjalësin ortodoks. Po kështu, Konica përdor saktë drejtshkrimin e titullit të priftit: “... e kish shkruar me talent *At Fan S. Noli*”.<sup>17</sup> Në fakt, trajta *At* përdoret nga Konica për etër ortodoksë e katolikë: “*At Gjeçovit* në Shkodër”.<sup>18</sup> Ekzistojnë sot sugjerime nga përdorues të kujdesshëm të shqipes, të cilët parapëlqejnë *Atë*, dhe jo *At*, por kjo ka dalë nga përdorimi i natyrshëm i standardit. Drejtshkrimi *At* është imponuar tashmë në shqipe.

<sup>11</sup> *Fausti i Ri*, cituar nga Faik Konica, *Vepra 1*, 2001, f. 78-80.

<sup>12</sup> *Shqipëria si m’u duk*, *Vepra 2*, f. 20.

<sup>13</sup> *Pralla e tregëtarit dhe e xhindit*, *Vepra 1*, f. 347.

<sup>14</sup> *Fushata*, *Vepra 3*, f. 282.

<sup>15</sup> *Përgjigje një Sërbi*, *Po aty*, f. 147.

<sup>16</sup> *Po aty*, f. 147.

<sup>17</sup> *Një histori e shkurtër e themelimit të “Vatrës”*, *Po aty*, f. 192.

<sup>18</sup> Titull letre drejtuar klerikut në fjalë (1897), *Vepra 4*, f. 31.



### **Lasgush Poradeci: O Zot, po rroj pëndesën e jetës më së nxire**

Deri këtu, pavarësisht nga paranteza te Konica, pamë se rilindasit janë kaq të shpenguar me “femëroren” e *Perëndisë*, saqë e lakojnë në sipërore, duke përveçësuar madje dhe mbiemrat “e Saj”. Duke kapërcyer shqipen eksperimentuese të Konicës, pothuaj kudo gjetkë gjejmë përdorimin e fjalës *Zot*, në vend të *Perëndisë*. Me epërsinë e përdorimit të sotëm, kjo duket kthjellët tek poezia e Lasgush Poradecit, pothuaj në gjithë veprën e tij, por sidomos në përsiatjet e tij filozofike: “O *Zot!* Po rroj pëndesën e jetës më së nxire...”, duke e titulluar madje poezinë “Njeriu dhe *Zot!*”<sup>19</sup>. I veçuar nga tokësorët, por dhe nga të shenjtat e tyre, ky poet nuk kapet kurrë liturgjik në përzgjedhjet e tij gjuhësore.

Ndërsa *Zoti* është fjala që Lasgushi ka përdorur më shumë, *Perëndia* përdoret nga ai me nuanca spirituale, njësoj siç e përdorim sot: “Një çikë frymë shentërije/ një çikë erë *perëndi!*”, tek poezia “Era e *perëndisë*”.<sup>20</sup> Kjo poezi mban nënshkrimin se është shkruar një të diel në mëngjes, “në shtrat”, në një rrugë me emër shenjtori, ndërsa të tjerët po shkonin të luteshin në kishë, ku pa dyshim

---

<sup>19</sup> *Vallja e përjetësisë*, cituar nga Lasgush Poradeci, *Vepra 1*, 1999, f. 107.

<sup>20</sup> *Zemra ime*, po aty, f. 237.

Llazari i vogël pati konsumuar qindra orë, të paktën, të kureshtjes feminare, të denja këto për një pickim të pashëruar të mekanizmit gjuhësor. Atje, në tempull, gjithçka përkthehej në shqipen dialektore të mjedisit, lektike apo semiotike, pavarësisht se ishte apo s'ishte *Perëndi*... Por ky është një hamendësim, i cili edhe sikur të mos përjashtojë hipotezën, nuk del nga tejdukshmëria e shqipes së Lasgushit.



### **Migjeni: Të lutem, o perëndi, për një simfoni**

Ndërsa në shqipen brilante të Lasgushit i Epërmi ishte *Zot*, tek Migjeni nuk mund të mos jetë *Perëndi*. Profet i të mjerëve, përdëllyes i të trishtuarve, ai që ngushëllon mbasi godet e hedh drejt vetënjohjes, tek thelbi i dhimbjes së bashkëkohësve, Migjeni i ka frazat si rrokje rituale, në kundërshti me përditshmërinë, zanimi i së cilave është gjuha e amëshuar e poetit, brejtja vetmevete e monologu për botën, zëri i atij që thërret në shkretëtirën e doktrinave spirituale e të zakoneve etnokulturore, të cilat po përvetësoheshin e po funksiononin si njerivrasëse.

Ashtu si dikush, shumë larg nga Shqipëria, do të shkonte në seminar ortodoks, e që andej mbas ndriçimit, a errësimit, do të skeletonte me të njëjtat eshtra zhvendosjen e një perandorie, të cilën Migjeni kishte fatin të mos ta shihte në të gjallë të tij në Shkodër, vetë ai përftoi në seminarin ortodoks, përmes përsëritjes

tekstuale, si shprehi rituale të paktën, vargëzime të tilla: “Të lutem, o *perëndi/* për një simfoni/ të dëfrej në lumni”.<sup>21</sup> E çfarë tjetër?

Sidoqoftë, kjo është një nga substancat e esencës *Migjeni*. Nëse e përgjithësojmë referimin e tij, në pjesën më të madhe poeti nuk është “lutës”. Në shumicën e rasteve ai është krejt ndryshe. Mbasi çan një vertikale të guximshme me qiellin, duke mbushur humnerën me duhmë, në vend të temjamt, horizontalja e Migjenit me tokësorët nuk bën gjë tjetër veçse kreshpëron shtestim e një kryqi, të një dhimbjeje: Mjerimi i shqiptarit, pa e përmendur me emër. Siç duket, kur njeriu mjerohet, ai shtingëllohet, shfisërohet, por nuk zhvargëzohet. E si mund ta lejojë ai pastaj gjuhën e botës të tëhuajë gjuhën e poetit, të shenjtat e tij, ku edhe një presje kryen funksione të mistershme. Migjeni parakalon në letrat shqipe jo si kalorës elitar, por si shtegtar eklektik, prandaj dhe nuk i pengon subjektet të nyjëtohen jo-poetikisht në tokën e tij, mjafton të thonë të vërtetën, sepse me poezi Migjeni vuan t’iu lëçitë shqipfolësve vdekjen e njeridashjes: “-A po na fal ndoj send zojë? - *Zoti* të dashtë!”<sup>22</sup> Dialektika e së folmes vendore.

Poezia e Migjenit vizatohet si kundërdogmë për përmbysje, pafuqishmëria ndaj hipokrizisë së institucionalizuar, prandaj dhe e klithur me të madhe. Ndërsa Migjeni vetë zgjedh të bëhet mik i gjehe nës së religjioneve të shtelbësuar ndër shqiptarë, dëgjohet opinioni spiritual i intelektualit (“specialisti i kulteve”, siç mund të quhej sot që nuk ka të tillë), ai që në njëjtën kohë paralajmëron esencën e klerit, pavarësisht nga pozita laike apo etiketa e keqkuptuar: “*Zoti* ndoshta kujdeset për trumcakë edhe priftët, por për mue s’e besoj”.<sup>23</sup> Në të folmen e qytetit të tij.

Duket se institucionet tokësore, edhe pse të sendeve hyjnore, kanë rënë dhe e kanë vlarë poetin, në të njëjtën kohë me sëmundjen e pashërueshme që i kumtonte vdekjen çdo agim. A mos vallë plagosja e thellë frymore që kërkon ta përjetësojë në vepër, fshihte një traumë të pashëruar shpirtërore në seminar, të cilën ai e bëzani si hakmarrje spirituale, pa e përshkruar fare, si e vetmja mbetje pasionesh për një të rënë? Ndërsa plagët e shpirtit nuk kanë shpirt, prandaj dhe nuk kanë përkatësi religjioni, plagësit-specie që nga ai çast kthehen në zëra të kudomishëruar. Përndryshe përse kaq i lakuar zëri liturgjik *Perëndi*, në një vepër kaq të kursyer me gramatikë? Ndoshta, ja pse duhet ndjerë Migjeni, përndryshe ai ka të drejtë të jetë gjykatar: “S’duem, për hir/ të kalbësinave të vjetra, që kërkojnë ‘shejtnim’/ të zhytmi prap në pellgun e mjerimit/ që të vajtojm prap kangën e trishtimit”.<sup>24</sup>

Kaq spiritual me dhimbjen, por dhe kaq i ndjeshëm me gjuhën, Migjeni ruan përdorimin liturgjik të ortodoksëve *Perëndi*, dhe jo *Hyj* të katolikëve, siç mund të pritej kjo nga një poet ritual i gegërishtes. Por kur ai përdor shumësin, prapë për

<sup>21</sup> *Lutje*, Migjeni, *Vepra*, 1998, f. 48.

<sup>22</sup> *Zoti të dashtë*, f. 99.

<sup>23</sup> *Zoti të dhashtë*, f. 100.

<sup>24</sup> *Të birtë e shekullit të ri*, f. 2



ritualizim, humbet brenda mistereve të shqipes, tek feja e poetit: “Njeriun-paljaço e krijoi absurditeti për me argtue *hyjtë* e natës, dritën e ditës dhe krijesat e dorës tjetër”.<sup>25</sup>

Interesant në tekstualitetin e Migjenit është përdorimi i mbiemrit *hyjnore*, i cili mbizotëron edhe në standardin e sotëm. Tek ky përdorim Migjeni jep përshtypjen se e ka menduar disa herë, dhe madje të numërt e ka renditur, problematikën tekstuale: “Atëherë, në këtë pezullim të njeriut, u zgjua në të ajo që nuk asht prej kësaj bote, ajo gjasend që i thotë pjesa qiellore, *hyjnore, perëndore* e ku dij ma...”.<sup>26</sup> Por edhe sikur ky të ishte një çast i vetëm, gjetkë ai vërtetohet njësoj përshtypjes: “... meritimi i lavdës nuk është tek ajo vetë, por tek ajo gjasend q’i thotë qiellore, *hyjnore, perëndore* e ku dij ma se kjo e bani njerëzinë t’i shpalli ultimatumin vetes”.<sup>27</sup>

Përsa i përket këtij përdorimi, Konica e Noli, edhe pse më afër një shqipeje më përfshirëse sesa gjuha vetëmbrojtëse e Migjenit, parapëlqejnë “e perëndishme” dhe “perëndore”, në vend të “hyjnore”. Faik Konica: “... të ngjitet në tru si një tip i hollë i nonjë bari të *perëndishmë*...”<sup>28</sup> Ndërsa Noli: “Mesh’ e *perëndishme* e Atit tonë nërmiet Shëntorët Joan Gojartit”, dhe “... nga pamjet *perëndore* mëndja m’u ndriçua...”<sup>29</sup>

Ashtu siç ka vënë radhë në përdorimin e mbiemrave, duke vënë *hyjnore* të parën, siç u trashëguar në shqipen e sotme, njësoj Migjeni rendit *Perëndinë* dhe *Zotin*, temën e leximit tonë “... e tërhiqte për kin të palltos, por lehtë, shumë lehtë, se kish frikë mos të zgjojë mnin e *zotit, e perëndisë*, e dreqit, mnin e këti njeriu-zotni deshta të them”.<sup>30</sup> *Zoti* ishte i pari, sepse është i njerëzve, *perëndia* është e dyta, sepse është e poetit, para se ai të humbasë në hyjnajë... Përmes poezisë, fillit të kërthizës, por dhe referencës tekstuale në poezi, si lajm gramatologjik, Migjeni ndihmon bashkëpërdoruesit e shqipes, duke bërë lojë me ta; një lojë si opinionin i mirëfilltë albanologjik.

Duke ecur në këtë lexim të Migjenit, bindemi se sjellim një enigmë për përsiatje të mëtejshme, sesa një përgjigje ndaj një pyetjeje. Përderisa tema jonë është e ngushtë, mund të them se përdorimi i termave *Perëndi* e *Zot* nga Migjeni është debatues edhe për pikëpyetjen ortodokse “toskërishte-gegërishte” në të kaluarën, aq më tepër kur nuk është folur për nuancat gjuhësore të gegëve ortodoksë, siç ishte Migjeni, por dhe të tjerë, e madje teologë e hierarkë të KOASH-it.

<sup>25</sup> Tragjedi apo komedi?, f. 72.

<sup>26</sup> Sokrat i vëjtun-A derr i kënaqun?, f. 68.

<sup>27</sup> Ose...-Ose, f. 70.


<sup>28</sup> Faik Konica, Dr. Gjëlpera zbulon rrënjët e dramës së Mamurrasit, Vepra 2, f. 94.

<sup>29</sup> Fan Noli, Librë e Shërbesave të Shënta të Kishës Orthodokse, Boston 1909, f. 65, dhe Vajtim për bijën (V. Hugo), Albumi II, 1966, f. 14.

<sup>30</sup> Një refren i qytetit tem, f. 78.

Përdorimi “ortodoks” këtu nuk bëhet për të përcaktuar përpjesat e Migjenit me fenë, sesa përkatësinë e tij kulturore, e cila është e cekët të mohohet me motive institucioni, në një kohë që ky poet është kaq mësimdhënës për klerin shqiptar të pasdiktaturës, sidomos për të rinjtë, për seminaristat, ku Milloshi përkiste, pavarësisht nga rrethanat, për t’iu kujtuar atyre të njëjtën përvojë kulturo-spirituale, e cila në vitet 30 ishte vetëm në fillimet e saj, por që sot është zotëruese. Disa poezi të Migjenit janë topikë të gatshëm për biseda, në qoftë se një prift ortodoks nuk fshihet nën mjerimin e përmbajtjes njerëzore, sidomos kur i dhimbset më shumë shqiptari i sotëm.

Lexuam këtu një poet me një të kaluar të pasur gjuhësore, përmes leximeve të mirëfillta në disa gjuhë, e në disa trajta tekstuale brenda shqipes, i cili jep shenja terminologjike në tekstualitetin e tij. Për sa i përket përpjestimeve të sotme në përdorimin e dy termave në fjalë, a përkatësve të tyre, nga folësit e gegërishtes më shumë përdoret nga ata *Zoti*, njësoj si në shqipen standarde: “...pse nuk ka ideal ma të lartë ‘tash e përgjithmonë e jetës’ se me njoftë *Zotin*, me pranue qenien e Tij, se me e dashtë *Zotin*, me i shërbye e me jetue për Atë” (Ipeshkëv Zef Simoni).<sup>31</sup>



---

<sup>31</sup> “Një përgjigje e kërkime”, *Alb-Club*, 15 janar 2005 (postim i Klajd Kapinovës).

## Fan Noli: Ti moj Perëndi e Dashurisë, shpëtona

Duke lexuar një vepër të hershme letrare të Nolit, pesë vjet më të vjetër nga viti 1907, kur u botua e përkthyer nga greqishtja në shqipe, menjëherë vëmë re se Noli këmbëngul në përdorimin *Perëndi*, dhe jo *Zot*, gjë që e ruajti gjer në fund të krijimtarisë së tij (Tema jonë është përdorimi *Perëndi* si *Theós* në greqishte, sepse *Kyrios* është përkthyer nga Noli në *Zot*). Ndërsa Migjeni kujdesej më tepër për thelbin e gjuhës, dhe jo për mbaresat e saj, sepse që të dy autorët kishin probleme me shqipen, pavarësisht se nga pozita të ndryshme, Noli mbeti një përdorues emocional i toskërishtes. Tek përdorimet e Nolit mund të zbulohen shumë emocione të autorit, ose të zhduken krejt. Djaloshi i ri që përpiket të shkruajë shqip, ruan trajtat kulturore të saj, ato që trashëgoi nga Thraka e largët, të përqasura e të njelmësuar me të folmet e bashkëmërgimtarëve nga Toskëria; për t'i imponuar në letër.

Si pasojë e këtij sfondi etnogjuhësor, *Perëndia* është e gjinisë femërore, dhe madje me një theksim të dyfishtë, të pazakontë, nga shkruesi: “Ti *moj* Perëndi e Dashurisë, shpëtona.”<sup>32</sup> Jo vetëm që është e *Dashurisë*, por *moj* e bën këtë përdorim krejt të feminizuar. Përderisa kemi një përkthim këtu, dhe jo një tekst origjinal, është e natyrshme që përkthyesi të jetë menduar mirë kur e ka përkthyer nga greqishtja. Nëse e përkthejmë mbrapsht në greqishtje, kjo frazë mund të ishte “O *Theé*”, ose “Re *Theé*”, gjë që atje sidoqoftë dëgjohet si një thirrje e ashpër, ndërsa në shqipe përkthimi del ëmbëlsisht ledhatues: *Moj! A tingëllonte kjo njësoj për Nolin e atëhershëm gjuhësor, apo është e kotë të rendësh mbas një përkthyesi që nuk kapet gjithmonë i përkthyer? Sepse ke të bësh dhe me njerishmërinë e tij.*

Mbas këtij eksperimenti, e shohim Nolin të përdorë trajta të ndryshme gjinore brenda një fjalie: “*Perëndia jonë* s’është def, ose kulçedrë, është *ay* me të cilën merret *Jakovi* dhe e shpie poshtë, është shkalla me të cilën të ngrenë ëngjëjtë mi fron’ e *tij*”.<sup>33</sup> Por si mund të jetë *Perëndia jonë*, dhe pastaj të bëhet *ai*, jo *ajo*, dhe pastaj *e tij*? Kjo tregon se korrektësia gjinore e të Epërmit nuk përfshihet në axhendën e atëhershme të Fan Nolit si autor, ndryshe nga ç’do të shohin në vijim.

E njëjta luhatje në përdorimin e gjinisë së *Perëndisë*, në krahasim me dramën *Israilitë dhe Filistinë*, regjistrohet dhe në përkthimet e para liturgjike të Nolit, 1908-1914, ku përkthyesi në parim përdor gjininë femërore të *Perëndisë*, por herë pas here kapet “i influencuar”, njësoj siç pamë tek drama në fjalë. Dy shembujt e mëposhtëm qëmtohen nga libri i parë dhe ai i fundit i kësaj periudhe përkthimore, me një hapësirë pesëvjeçare nga njëri-tjetri: “... *Perëndia jonë*

<sup>32</sup> *Israilitë dhe Filistinë*, Boston 1907, f. 45-46.

<sup>33</sup> Po aty, f. 41

njerzidashëse, që i akseptoij n'Alltar të tij të shëntë...<sup>34</sup> dhe "Të falurit t'im *Perëndisë* do t'ia dërth, dhé *atî* do t'i trégoj hidhërimét é mia".<sup>35</sup> Pra, ndërsa përkthyesi përdor planifikueshëm gjininë femërore të *Perëndisë*, trajtën kulturore *jonë*, ka raste, përmes një korpusi të dendur tekstesh të atyre viteve, kur hija e Kristoforidhit, ose hijet e përbashkëta, nuk e trashëgojnë përkthyesin të njëtrajtshëm, prandaj dhe *Perëndia jonë* bëhet herë *ajo* e herë *ai*, apo *atij*, e *tij*...

Ndryshe është në periudhën e dytë të përkthimeve kishtarë, 1941-1952, ku Noli e "mashkullarizoi" *Perëndinë* kryefund. Një nga arsytet e ideologjisë së Nolit mbi gjininë e *Perëndisë*, ishte shmangia nga çështje që kërkonin debate teologjike. Në këtë rast gjinia nuk shpjegohet ndryshe nga Kristoforidhi në të kaluarën, apo nga ortodoksia zyrtare në Shqipëri, në të tashmen e tij, përveçse me motive teologjike, mbi simbolikën mashkullore të Zotit të krishterë, si model i gatshëm në marrëveshjet përkthimore (Le të merreshin teologët me asi punësh...).

Nga pikëpamja tekstuale, një nga ndryshimet gjuhësore midis dy periudhave përkthimore nuk është ecuria e autorit në shqipe, a ngurtësia në terminologjinë kishtarë, siç mund të priste dikush, sesa lëmimi i pikëpamjes gjinore në tekstualitet. Jo vetëm në adhurim, por dhe në letërsi, Noli dokumentoi të njëjtën gjë, duke ndryshuar përdorimin e *Perëndisë* në mashkullore: "Ja ku të vinj, o *Zot*, dhe proklamoni që *je/ I mir' i ëmbl' i dhëmpshur, Perëndi i Jetës/ I vetëm që di se ç'bën dhe përse*"<sup>36</sup>. Duke e trajtuar veten si nxënës në shqipe, për gjithë jetën, nga njëra anë Noli respektonte intuitën e tij kulturore të toskërishtes, por nga ana tjetër pranonte sugjerimet e një realiteti tejkalues; me modesti tërheqëse.

Kur pranoi *Perëndinë* në mashkullore (*Perëndi i Jetës* dhe *jo e Jetës*), jo vetëm që Noli ra dakord me Kristoforidhin, ndryshe nga më parë, por u bë më i shtirur në terminologji, edhe pse në kahun e ndërsjelltë; Kristoforidhi i pati mëshuar purizmit, duke shkukur nga gjuha çdo fjalë të huaj, qoftë dhe me rrënjë njësoj të thella ndonjëherë, ndërsa Noli tashmë po përjetësonte fjalë të huaja në shqipe, të cilat në periudhën e parë ishin më të pakta, plus që ishin dëgjuar atëherë si kalimtare, përderisa fillimi i veprës liturgjike ortodokse përkoi me fillimin e priftit të ri në letrat shqipe.

Disa prej këtyre fjalëve të huaja janë krejt të pashpjegueshme, sidomos nëse nuk thellohem në botën kulturore të autorit. Për shembull, është e lehtë të anashkalojmë foljen "akseptoij" që hasëm më sipër, sepse kjo konceptohet në vitet 10, por çfarë hiri përçon folja "proklamoni" në vitet 60, për një autor të plakur në lëmin e përkthimit? Ose më mirë, në çfarë ujëvare gjuhësore zbrisnin shkrimtarët bashkëkohës në Shqipëri, dhe ku mëtonte të ngjitej e të mbetej Fanoli?

<sup>34</sup> *Librë e Shërbesave të Shënta të Kishës Orthodokse*, 1909, f. 99.

<sup>35</sup> *Lutjesore*, 1914, f. 85.

<sup>36</sup> *Vajtim për bijën* (V. Hugo), *Albumi II*, 1966, f. 15.

Gjuha e viteve 60 në Shqipëri, në krahasim me prelatin e mërguar, të jep përshtypjen se lëvrohet në një shekull tjetër. Pra, për sa i përket gjuhës letrare, Noli këmbëngulte në vetvete. Ndoshta përkushtimi tek anglishtja, si gjuhë parësore për të, për më të dashurit e përditshëm, por dhe për grigjën e tij; varfëria e shqipes së gjallë të bashkëbiseduesve në mërgim, përderisa shumica e shqiptarëve të ardhur nga Shqipëria ishin të paarsimuar e tashmë të moshuar, domethënë gjuhësisht të zhbalancuar (për dijetarin e zhgënjyer nga mësimi, shqiptarët nuk shkaktonin më çastet e shkuara ngazëllyese, kur ata dinin vetëm shqip dhe vetvetishmëria shprehimore i kishte shndërruar në subjekt hulumtimi kulturor); vetëveçimi gjuhësor i intelektualëve të tjerë shqiptarë në ShBA; përsiatja e tij e përhershme me një botë tjetër tekstuale, e cila më në fund e mundi kërsërinë, e të tjera shkaqe, nuk ishin pak.

Librat që i dërgonin Nolit nga Shqipëria, jo vetëm që ishin një grimë e gjithë asaj gramatologjie që po rrëmbehej kaq tekstualisht, por ka të ngjarë që Noli të mos i lexonte fare, përndryshe si mund ta anashkalonte ai detyrimin e intelektualit për të lexuar e cituar veprat e bashkëkohësve? Noli nuk jep shenja bashkëlidhjeje me ato rryma filozofike ku mund shpërnjihen veprat e bashkëkohësve me motive përkatësie. Nëse debatojmë sot mbi sensin, tiparet dhe imponimin e një Shqipërie virtuale, tej gjeografisë a pikave të prekshme, lidhja kulturore e Nolit me realitetin shqiptar mund të kuptohet si e paraprirë.

Le të kthehemi tek qerthulli i kësaj trajtëse, tek përdorimi *Perëndi* dhe sidomos tek femërorja e mashkullorizuar në shqipe. Mbas gjithë këtij leximi, ku pamë përpjekje institucionale për të planifikuar tendencat gjinore të emrave gramatikorë, ekzistojnë dëshmi të mjaftueshme se kjo nuk funksionon gjithmonë shpenguar as në tekstualitetin e sotëm ortodoks. Megjithëse *Libri i Shërbesave* është botuar e kontrolluar shumë herë në shqipe (1909-1994), prapëseprapë tek botimi i fundit ka raste kur *Perëndia* është në femërore. Për shembull, tek “Urata e himnit Keruvik”, ndërsa teksti fillon me gjininë mashkullore, “... se vetëm ti, o Zot Perëndia ynë, i sundon qielloret...”, më poshtë përfundon në femërore: “Ai që pranon dhe që jep vetveten, o Krisht Perëndia jonë...”<sup>37</sup>

---

<sup>37</sup> *Libër i Shërbesave të Shenjta të Kishës Orthodhokse*, Tiranë 1994, f. 98-99. Tek i njëjti botim, ka shembuj të ngjashëm, si tek “Shërbesa e përgatitjes për kungim...”: “Perëndisë sonë...” (f. 339), “Perëndisë së Jakovit...” (f. 241), “Biri i Perëndisë së gjallë...” (f. 251), e ndoshta dhe gjetkë. E njëjta gjë dokumentohet edhe një vit më vonë, tek botimi më vete e Meshës së J. Gojartit, ku megjithë ndreqjet e dukshme, *Perëndia* nuk është “mashkullorizuar” plotësisht: “... por përpara teje, Perëndisë së frikshëm...”, *Liturgjia Hyjnore e Atit tonë ndër Shenjtorët Joan Gojartit*, Tiranë 1995, f. 72.



### **Jakov Xoxa: O zot, përbuzja jote qenka si shiu**

Në të njëjtën periudhë tekstuale për Nolin dhe shqipen, në vitet 60, le të shohim përdorimet *Perëndi* dhe *Zot* tek bashkautorët e tij në Shqipëri. Po lexojmë shkrimtarin Jakov Xoxa, si një nga më të spikaturit ato vite, por sidomos shkrimtarin që lakonte më shumë atëherë dy termat e këtij debati: “Shyqyr që na takoi *perëndia* rrugës, se *zoti* e di si do të rronim kështu të gjallë mes të të vdekurve e të vdekur në mes të të gjallëve...”<sup>38</sup> Në këtë fjali duket se në fjalësin e shkrimtarit dy termat *Perëndi* e *Zot* kanë të njëjtën rëndësi. Përderisa është një fjali rrëfyese, me nota bisedimore dhe të çiltëra, *perëndia* është e para.

Por kur personazhet janë shpërthyes, ajo që vjen e para të artikulohet është *Zoti*: “O zot! Përbuzja jote qenka si shiu, merr që lart poshtë: Beu përbuz agallarët, agallarët subashllarët, subashllarët kosovarët, kosovarët myzeqarët, myzeqarët sarakaçanët, sarakaçanët evgjitet, evgjitet arixhinjtë, arixhinjtë... O zot! Ç’është ky mallkim i yt që bije nga lart mbi njerëzi!”<sup>39</sup>. Përdorimi ritual i Nolit (*Perëndi*), pra, është larg përdorimit të natyrshëm në shqipen letrare (*Zot*). Duke lexuar

---

<sup>38</sup> Jakov Xoxa, *Lumi i vdekur*, Tiranë 1967, f. 160.

<sup>39</sup> Po aty, f. 205.

*Lumin e vdekur* ndjen dikush se kjo gjuhë që ishte dje, është sot, do të jetë dhe nesër; i njëjti truall shprehimor.

Nuk ka dyshim se në shqipen e atyre viteve *Zoti* përdoret pothuaj nga të gjitha personazhet, pavarësisht nga kategoria e tyre gjuhësore. Në thirroret e përsëritura *Perëndia* futet vetëm për ta bërë më shkrehëse në përdorim, ose për të mbrojtur prozën nga vjershezimi:

“O zot, po shuajnë kasollen e po mbytin robt! ... dhe brodhi, nëpër ujë, drejt mesores, për të dalë përjashta.”

“O *perëndi*, ç’është kjo kështu? Paskan zbrazur pusët mbi kasollen time!... Po njerëzit ku kanë vajtur?”

“O zot” U ngjall lumi i Vdekur!... klithi gruaja, vetëm, në mes të ujit dhe të shiut; të ujit që rritej çdo hap nga toka e të shiut që shtohet çdo minutë nga qielli”.<sup>40</sup>

Nuk ka nuanca dalluese në këto tri përdorime, sepse *Perëndia* ndërfitet sa për freski, për të mos monotonizuar përdorimin zotërues, *Zot*.

Siç shohim më sipër, dy emrat e përveçëm *Perëndi* dhe *Zot* shkruhen me shkronjë të vogël, si në gjithë romanin, gjë që ekziston vetëm pjesërisht tek Migjeni e Lasgushi, duke dhënë përshtypjen e letrarizimit të terminologjisë spirituale. Viti 1967, kur u botua ky version i ripunuar i *Lumit të vdekur*, përkoj dhe me botimin e *Rregullave të drejtshkrimit të shqipes*. Pastaj 1967-a ishte viti “antihyjnor”; që nga shkurti e deri në nëntor u trajtëzua procesi për shpalljen e Shqipërisë institucionalisht ateiste. Nuk dimë nëse ky drejtshkrim është i autorit apo i shtëpisë botuese. Nga ana tjetër, duke lexuar *zot* dhe *perëndi*, vetë kjo të jep një ndjesi shplodhjeje, sidomos sot, kur shkronjat e mëdha në terminologjinë spirituale rrezikojnë të mbysin gjithë shkronjat e vogla.<sup>41</sup>

Kjo mëtohet nëpërmjet hijes së anglishtes a të greqishtes, fjala bie, edhe pse përdorimi pa vend i shkronjave të mëdha e banalizon domethënien e termave, sepse shqipja, duam s’duam, ka çarë një shteg tjetër gjuhësor. Gjithsesi, Jakov Xoxa regjistron me një vëzhgim të mprehtë gjuhësor në tekstualitetin e tij. Ka pasur epoka tekstuale kur nuk kishte shkronja të vogla. Çdo dorëshkrim

---

<sup>40</sup> Po aty, f. 283-284.

<sup>41</sup> Tek botimi zyrtar i Akademisë së Shkencave, përcaktohet se “Shkruhen me shkronjë të madhe emrat e përveçëm të botës mitologjike e fetare [...] (por shkruhen me shkronjë të vogël emrat e përgjithshëm të sferave të mësipërme si *allah, engjëll, perëndi, perri, shenjt, xhind, zanë* etj.)”, *Drejtshkrimi i gjuhës shqipe*, Tiranë, 1973, f. 146. Si në vitet 60, me Jakov Xoxën, aq dhe në vitet 70 e më tej, me institucionin e standardit, shohim edhe sot të sugjeruar profesionalisht, të njëjtin drejtshkrim: “Emrat e përgjithshëm fetarë shkruhen me shkronjë të vogël: *allah, orakull, perëndi, shenjt, zanë, zot, xhind, shtojzovallë* etj., Rami Memushaj, *Shqipja standarde - si ta flasim dhe ta shkruajmë*, Toena, 2004, f. 169. Gjithsesi, shkrimi me shkronjë të vogël i fjalëve *perëndi* e *zot* nuk përbën pengesë për tingëllimin e këtyre nocioneve sot, por as dhe pranimiti i tyre universal është i lehtë. Në rastin tim, duke pranuar *at* e *shenjt* jo me të madhe, *Perëndia* dhe *Zoti* janë, ndoshta, e vetmja shkelje e vetëdijshme e drejtshkrimit të standardit.

përjetësohej vetëm me shkronja të mëdha, e madje pa shenja pikësimi. Të njëjtën ndjesi, ndërsjelltas, të jep vogëlshkronjëzimi si veçori, kur periodizojmë një letërsi vendore; tek *Lumi i vdekur*.

Jakov Xoxa duket se jo vetëm regjistron të folmen e personazheve të tij, por na sjell nuanca që shprehin ideologjinë shprehimore të tyre. Për shembull, që të kthehemi tek gjinia e *Perëndisë*, në gojën e at Thanasit shohim të përdoret disa herë *Perëndia*, si zëdhënës i ritit dhe folës i mistereve, dhe madje e përdorur në mashkullore, ashtu siç do ta përdorte një prift ortodoks që i qëndron besnik atyre gjërave që i thonë shkrimet e tij: “*Perëndia*, i paçim uratën, që është *shënjt mbi shënjtë* e s’di nga prapësitë e djallëzitetë e Satanit...”<sup>42</sup> Pra *Perëndia* është *shënjt*, jo *shenjto*, sepse ati e përdor në mashkullore, ndërsa kudo gjetkë në roman përdoret nga “laikët” në femërore; flasim për ato raste kur e përdorin, sepse rëndom ata paraqëlqejnë *Zotin*. Gjithashtu dhe nuancat e së folmes gege në dialogët e romanit sjellin trajtën *Zot* dhe jo *Perëndi*: “Jo, asha *zotin*, për pa me u shndosh Sulejman Tafili, s’la kush me i qit fjalë për këtë!”<sup>43</sup>



---

<sup>42</sup> Po aty, f. 630.

<sup>43</sup> Po aty, f. 594.



## “Zot” a “Perëndi”?

Duke mbërritur tek Jakov Xoxa, tek gjuha “standarde” e *Lumit të vdekur*, ndihemi sikur kemi gjetur fillin e këputur të terminologjisë spirituale, në vitin 1967, atë që vazhdojmë të endim sot e për shumë kohë që vijnë. Nga sa u thanë në këtë trajtesë, del se fjalët *Perëndi* e *Zot* janë të njëkuptueshme e të barabarta në shqipen e dy shekujve të fundit, të paktën, pavarësisht nga luhatjet e përdoruesve e larmia e lëndës.

Edhe pse fjala *Perëndi* ruan nuancat e saj tek disa autorë, me lërimin e shqipes si gjuhë kombëtare, e sidomos si gjuhë letrare, përdorimi *Zot* ka marrë përparësi si një përzgjedhje e vetvetishme, e paplanifikuar në burimet standarde të gjuhës. Veç kësaj, gjinia femërore e *Perëndisë*, atje ku përdoret, është një lëvizje njësoj spontane për përdoruesit e shqipes letrare, sidomos kur ata nyjëtohen jashtë hijes së terminologjeve spirituale, të cilët e mëtojnë në mashkullore, me motive ekskluzive.

Që nga Naim Frashëri e gjer tek Jakov Xoxa, e që atëherë e deri më sot, pamë se përdorimi *Zot* është zotëruar për shqipfolësit, të paktën jashtë shprehjeve rituale e tej shkrehjeve emocionale. *Zoti* është përzgjedhja më e afërt gjuhësore për atë që në greqishte është *Theos* e në anglishte *God*, pavarësisht se kjo nuk përkon me ato gjuhë me të cilët janë në kontakt shqiptarët e sotëm.

© At Foti Cici, 2007

Versioni fillestar i kësaj trajtese u botua i shkurtuar tek gazeta shqiptaro-italiane *Bota Shqiptare*, 27 janar – 24 shkurt 2005.